



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
MINISTRI

UDHËZIM

Nr. 4139 Prot

Nr. 11, datë 20.05.2022

PËR

DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 20.04.2022 "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS, LLOJIT DHE MËNYRËS PËR DHËNIEN E SHËRBIMEVE ONLINE TË SHËRBIMIT GJEOLGJIK SHQIPTAR",

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 111/2015 "Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, të vendimit nr. 111, datë 2.3.2022 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë", si dhe në përputhje me Urdhrin e Kryeministrit, nr. 153 prot., datë 25.11.2019, "Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line nga data 1.1.2020",

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 10, datë 20.04.2022, "Për përcaktimin e procedurës, llojit dhe mënyrës për dhënie e shërbimeve online të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar", bëhen ndryshimet si më poshtë:


1. Shkronjat "c" dhe "ç" të pikës 5, ndryshojnë dhe bëhen si më poshtë vijon:

a) "c. Pas plotësimit të formularit elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara, bëhet konfirmimi i pagesës.";

b) "ç. Kërkuesi brenda 30 ditë pune, nga konfirmimi i pagesës, njoftohet në seksionin "Dokumentet e mia", në portalin e-Albania, për shërbimin e kërkuar."

2. Ngarkohet Shërbimi Gjeologjik Shqiptar për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


MINISTRI
Belinda Balluku
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
TIRANË